



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

nr _____

Dt: 18.11.2015

Drejtoresha e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik të Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 62.3 dhe 66.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L -040, si dhe në Përfundimin 01 nr. 06-75711-5/1 i miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve me dt:23.10.2015, me të cilin është autorizuar Drejtoria për Zhvillim Ekonomik për krijimin e kushteve për menaxhimin e kiosqeve, me dt: 18.11.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për marrjen e veprimeve për krijimin e kushteve të menaxhimit të kiosqeve, të cilat kanë mbetur pa u menaxhuar pas ndërprerjes së kontratës me operatorin ekonomik NNT “EKO”, në këtë përbërje :

1. Kujtim Asllani, kryetar i komisionit
2. Fatos Deda, anëtar
3. Shpat Nivokazi, anëtar

2. Komisioni i theksuar në pikën e parë të këtij vendimi duhet të angazhohet për kryerjen e detyrave vijuese :

2.1 Menaxhimi i kiosqeve duhet të bëhet me qëllim të krijimit të kushteve për mbikëqyrjen e tyre nga organet kompetente të administratës publike të Komunës së Gjakovës, duke ndërmarrë veprimet në harmoni me të dhënat dhe sugjerimet nga procesverbali i Komisionit për evidentimin e kiosqeve .

2.2 Verifikimi i lejeve dhe kontratave me NNT “EKO” si dhe raportit final të këtij komisioni .

2.3 Ftesa e shfrytëzuesve të kiosqeve të cilët më parë janë menaxhuar nga NNT “EKO” , për lidhjen e kontratave të reja në harmoni me aktet tjera komunale me të cilat rregullohet kjo fushë .

2.4 Komisioni duhet të bashkëpunon me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe me Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për hartimin e raportit financiar, në të cilin do të prezantohen të dhënat për borxhin e NNT”EKO” ndaj Komunës së Gjakovës të evidentuar në bazë të kontratës nr. 093 të dt: 19.01.2009 dhe këtë raport t’ia përcjell Avokaturës Publike të Komunës së Gjakovës për përgatitjen e padisë ndaj NNT”EKO”, me kërkesëpadi për kompensimin e borxhit i cili është shkaktuar për shkak të mos përmbushjes së obligimeve të kontraktuara.

2.5 Detyra tjera të ngjashme të cilat dalin nga puna në vazhdim të procesit për menaxhim të mirëfilltë të kiosqeve.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

4. Vendimi iu dorëzohet:

- Kabinetit të Kryetares së Komunës
- Zyrës së Prokurimit
- Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
- Anëtarëve të Komisionit
- Arkiva

**Drejtoresha e Drejtorisë
për Zhvillim Ekonomik**

Znj. Silvana Domi